



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery		28.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shojca Prilog Appendix		Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICA	3775/2022			115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.460/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Flaxhnikaj Demi dhe Jeton Kocanëtarë, me Sabile Avdyli- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.460/2022 të datës 17.05.2022 të parashtruar nga ankuesja _____ përmes avokatit me adresë: _____ kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjakshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.06.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.460/2022 e datës 17.05.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Obligohet Menaxheri i e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi të rregulloj statusin e ankueses dhe te njëjtës ti lëshoj Akt Emërim të përhershëm lidhur me pozitën sipas Kontratës së punës të datës 03.07.2017.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që të kujdeset për zbatimin e vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën e punës "Zëvendës Drejtoresh e Qendrës Korrektuese në Lipjan", përmes avokatit me datën 17.05.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me numër protokoll: 2877/2022 me pretendimet se sipas nenit 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me akt emërim dhe përveç kur parashikohet ndryshe me ligj është e përhershme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 30.05.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Këshilli, me datë 31.05.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoll 3178/2022 se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 17.05.2022 me numër protokoll 2877/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 14.02.2022; Kontratë për kohë të caktuar e datës 22.07.2015; Njoftimi i datës 01.02.2022; kërkesa e datës 10.05.2022 me numër protokoll 354 për Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Përgjigje në kërkesë e datës 13.05.2022 me nr.0543; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 31.05.2022 me numër protokoll 3178/2022 bashkë me shkresat e lëndës. Kontratë e punësimit e datës 02.07.2012 deri më datën 01.07.2015; Konkursi i datës 03.05.2012 -17.05.2012 kur është zgjedhë **Zëvendës Drejtor në Qendrën Korrektuese në Lipjan në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Aplikacioni i datës 11.05.2012 për formularët e vlerësimit për rezultatet në punë për vitin 2020 dhe 2021.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja fillimisht marrëdhënien e punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën "Zëvendës Drejtoresh në Qendrën Korrektuese në Lipjan" ka themeluar mbi bazën e legjislacionit të shërbimit civil pastaj të vazhduar sipas Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si dhe Ligjit Nr. 03/1-212 të Punës, sipas kontratës së datës 02.07.2012, kontratës së punës të datës 03.07.2017, ndërsa të njëjtës sipas kontratës së fundit të vitit 2017 mandati i saj përfundon me datën 02.07.2022.

Ankuesja më datë 01.02.2022 njoftohet nga Menaxheri i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, se marrëdhënia e punës ankueses i skadon me datë 02.07.2022, me datë 10.05.2022, ankuesja i drejtohet me kërkesë Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës për shndërrimin e kontratës së punës në Akt emërim të përhershëm duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Në përgjigje të kërkesës së ankueses, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes shkresës me numër protokoll 0545 të datës 13.05.2022 ka refuzuar kërkesën e ankueses për rregullim të marrëdhënies së punës me arsyetimin se ankuesja ka themeluar marrëdhënie të punës në bazë të

dispozitive të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me afat të caktuar, andaj edhe kontrata e punës me afat nuk mund të kthehet me afat të pa caktuar.

Ankuesja e pakënaqur me Përgjigjen me numër protokoll 0545 të datës 13.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, brenda afatit ligjor parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të moszbatimit të dispozitive të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë nga organi i punësimit, duke shtuar me tej se mos rregullimi i marrëdhënies së punës respektivisht mos shndërrimi i kontratës së punës me afat të caktuar në Akt Emërim të përhershëm është në kundërshtim me nenin 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të obligoj Shërbimin Korrektues të Kosovës që ankueset t'i rregulloj marrëdhënien e punës me akt emërim me afat të pacaktuar.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ju referua dispozitive të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020, gjegjësisht neni 4 paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar se: *1.Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, 2.Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, rrjedhimisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht marrëdhënia e punës dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës i nënshtrohen rregullimit ligjor sipas Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë dhe ligjeve të veçanta lidhur me fushat e specifikuara sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji.*

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar dispozitat tranzitore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 83 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Një punonjës aktual, që nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), por që e mban një pozitë, e cila është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë sipas nenit 2, paragrafit 3 të këtij ligji, do të emërohet si nëpunës civil sipas këtij ligji, nëse i plotëson këto kushte: 2.1. ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, dhe 2.3. është vlerësuar për rezultatet në punë në këto dy vjet të paktën "mirë".* Ndërlidhur me këtë neni 8 i po këtij Ligji ka përcaktuar se: *1.Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji dhe 2. Përoç kushteve që parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatët, për t'u pranuar si nëpunës civilë, nëpunës të Shërbimit Publik dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kërkesa: 2.1. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës",* Andaj, mbi këtë bazë ligjore si dhe mbështetur në shkresat e lëndës Kolegji vlerëson së në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore sipas

nenit 83 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pasi që ankuesja para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka qenë në marrëdhënie pune në Shërbimin Korrektues respektivisht ankuesja që nga viti 2012 ka ushtruar pozitën e *Zëvendës Drejtoresh e Qendrës Korrektuese në Lipjan* dhe se kjo pozitë konsiderohet pozita e nëpunësit civil e konfirmuar edhe nga vet organi i punësimit sipas emalit të datës 22.03.2022 dhe si e tillë është e përcaktuar me nenin 86 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Rregullores në fuqi QRK-Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu nga vlerësimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas Formularëve për Vlerësimin e Rezultateve të Punës, ankuesi është vlerësuar për vitin 2020 me notë të përgjithshme 4.65, kurse për vitin 2021 me notë të përgjithshme 4.15, rrjedhimisht ankuesja për dy (2) vite ka qenë e vlerësuar me notë "shumë mirë" dhe se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se ankuesi ka në fuqi masë disiplinore "largim nga një pozitë e zyrtarit publik" apo se i njëjti është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale mbi bazën e të cilit ankuesja ka lidhur marrëdhënien e punës ka përcaktuar kriteret e rekrutimit për pozitën e Drejtorit dhe Zv/Drejtorit të institucionit korrektues, përkatësisht me nenin 217 paragrafi 4 përcaktohet se: *Detyrën e drejtorit të institucionit korrektues mund ta ushtroj personi (kandidati) i cili i plotëson kushtet në vijim: 4.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 4.2. të ketë përgatitje universitare; 4.3. të ketë gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku tri (3) vite përvojë pune në pozita udhëheqëse; 4.4. të mos jetë anëtarë i ndonjë partie politike; 4.5. të ketë reputacion moral dhe profesional, dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale..* ndërsa paragrafi 7 i nenit 217 të të njëjtit ligj parasheh se: *7.Institucionet korrektuese mund të kenë edhe zëvendës drejtorët të cilët emërohen sipas procedurës, kushteve dhe kohëzgjatjes të parapara për drejtorët e institucioneve korrektuese, rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në konfirmimin e datës 16.06.2021 të Njesisë Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB ka bërë shqyrtimin, verifikimin dhe deklarimin e statusit të zyrtarëve publik dhe se pozita "Zëvendës Drejtor në Qendrën e Paraburgimit" është klasifikuar pozitë e nivelit drejtues të ulet me afat të përhershëm, fakt ky i vërtetuar edhe përmes Konkursit për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00008066 të datës 07.02.2022 për pozitën "Zëvendësdrejtor i Qendrës Korrektuese- Qendra Korrektuese në Smrekonicë".*

Ndërlidhur me çështjen në vendosje, Kolegji konstaton se organet e administratës publike kanë qenë të obliguara që sipas detyrës zyrtare të bëjnë rregullimin e statusit të zyrtarëve publikë në pajtim me nenin 83 paragrafi 16 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklarimit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative, përkatësisht Njësia e Personelit të Shërbimit Korrektues ka qenë e obliguar të bëjë rregullim ex officio të statusit të nëpunësve të Shërbimit Korrektues përfshirë edhe rregullimin e statusit të ankueses gjegjësisht të shndërroj kontratën e punës me afat në Akt emërim të përhershëm, kështu që mbi këtë bazë Kolegji konstaton se nuk qëndron arsytimi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së së ankuesja ka themeluar marrëdhënie të punës në bazë të dispozitave të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me afat të caktuar, andaj edhe kontrata e punës me afat nuk mund të kthehet me afat të pa caktuar.*

Andaj, bazuar në gjendjen faktike dhe bazën ligjore si me lartë, dhe pas konstatimit se janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për rregullimin e statusit të ankuesit në pajtim me nenin 83 paragrafi 2 dhe

nenin 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, ndërsa obligohet Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi të rregulloj statusin e ankuesit dhe të njëjtit ti lëshoj Akt Emërim të përhershëm lidhur me pozitën sipas Kontratës së punës të datës 03.07.2017.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.460/2022; datë 28.06.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Avokatit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.